

SVETISLAV BASARA
ZEMRA E TOKËS
(STUDIM MBI QËNDRIMIN E NIÇES NË QIPRO)

BOTIMET TOENA

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zviceran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

SVETISLAV BASARA

ZEMRA E TOKËS

(Studim mbi qëndrimin e Niçes në Qipro)

Përktheu nga origjinali serbisht
Milena Selimi

BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Svetislav Basara
Titulli në origjinal: Srce zemlje
Botoi në serbisht: Narodna Knjiga

Një pjesë e librit është punuar në rezidencën “Krokodil Center”,
Serbi, projekti READ.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktor: Eris Rusi
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376695

© e përkthimit: Fondacioni S. Fischer me porosi të TRADUKIT
© Svetislav Basara, 2004
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi
me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim
të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

Zoran Xhinxhiqit

*Historia e botës është gjyq mbi botën.
“Fenomenologjia e shpirtit”*

SHËNIM I PËRKTHYESIT

Shpesh harrohet se përkthyesi është një kufitar, me të gjitha kuptimet që bart kjo fjalë. Ai vetëkrijon kufirin përtej të cilit kalon plaçkën e tij. Ai i ngjan lundërtarit, varka e të cilit lundron nëpër detin e trazuar të lllomotitjes barbare drejt bregut “tjetër”. Këtu s’ka përkthyes me gojë. Në botën e përkthimit s’ka vend për dragomanë¹ që sillen përreth sallave të gjyqit, as për lektorë që do të përkujdesen për përputhjen e të dy teksteve, as për “papagaj simulantë” nga Kombet e Bashkuara.

Ivan Iliç

Studimi “Zemra e Tokës” është publikuar për herë të parë nga shtëpia botuese “Alfa Mega” në Buenos Ajres në serinë “Dorëshkrime të gjetura rastësisht”. Ndërkohë, unë kam lexuar dhe zotëroj vetëm përkthimin anglisht me parathënien e Adolfo

¹ Një përkthyes dhe udhërrëfyes në Lindjen e Afërt; në Perandorinë Osmane në shekujt 18-19 një përkthyes i gjuhëve europiane për autoritetet turke, arabe dhe perse. (Shënim i përkthyesit.)

Bioj Kasaresit, botuar në Nikozia nga “Mouphlon Books-shop Press”, viti 2000. Disa fjalë nga shënimet e parathënies së autorit anonim, të cilat me siguri nuk do t'i shpëtojnë vëmendjes së lexuesit, tregojnë qartë se nga kombësia ai ka qenë (apo vijon të jetë ende) serb. Por ky fakt nuk ishte përcaktues i vendimit tim për përkthimin dhe më vonë botimin e këtij studimi. Motivi kryesor është vetë tema e librit: detaje të panjohura nga jeta e Fridrih Niçes dhe qëndrimi i tij *incognito* në Qipro në vjeshtën e vitit 1882. Pastaj vijnë të tjerat: rrethanat enigmatike, përqsasjet e mrekullueshme dhe ngatërimi i gjurmëve, të cilat si një re mistike mbështjellin strukturën komplekse të tekstit. Dhe në fund: aventura joshëse e përkthimit të diçkaje të shkruar serbisht në origjinal; njëfarë riatdhesimi i një dëshire, e cila pas goditjeve nëpër hapësirat e paskajshme të spanjishtes dhe të anglishtes, më në fund kthehet në ankthin e gjuhës amtare.

Sigurisht me kushtin që, përgjithësisht, vepra të ishte e shkruar serbisht. Mundësia që “Zemrën e Tokës” ta ketë shkruar një njeri tjetër, dikush që autorin e *Parathënies* vetëm sa e ka prezantuar si serb, me shtetësinë e dyfishtë fiktive, a nuk do të përforconte atmosferën e shpërqendrimit dhe të së panjohurës? Një mundësi e tillë mbetet e hapur, aq më shumë se në të gjitha këto me një *Parathënie* emocionuese është i përzier edhe miku i Borgesit, Mjeshtri i Madh i Shoqatës së mistifikatorëve letrarë, Adolfo Bioj Kasaresi. Në të vërtetë - lexuesi

do të bindet vetë - shumë rreshta të librit mund t'i shkruajë vetëm një serb. Ose ndonjëri që të paktën paraqitet si i tillë. Tani para nesh hapet një greminë me shumë pyetje pa përgjigje: A nuk është ndoshta libri “Zemra e Tokës” një roman i Borgesit, të cilin për mospërputhjen poetike me krijimtarinë e tij më të hershme, autori nuk ka dashur ta publikojë me emrin e vet dhe ka vendosur ta botojë me parathënien e Bioj Kasaresit si një pranim i tërthortë, krejtësisht borgezian i autorësisë?

Apo autori i vërtetë është Adolfo Bioj Kasares, i cili e përdor *Parathënien* si zonë neutrale midis dy poetekave: klasikes, së cilës i përket, dhe postmodernes, sfidën e së cilës nuk e përballon dot në fund të jetës së tij, por nuk dëshiron që ky fakt të njihet publikisht.

Këtë s’kemi për ta marrë vesh kurrë!

Pas mbarimit të përkthimit iu drejtova Agjencisë Argjentinase të Autorit për të blerë të drejtën e autorit. I shkrova dhe Adolfo Bioj Kasaresit me lutjen të më përgjigjej në qoftë se dinte më shumë sesa zbulohej në *Parathënien* e tij për “Zemrën e Tokës”. Përgjigjja që erdhi shumë shpejt nga Agjencia më siguronte se ngurrimet në lidhje me “Zemrën e Tokës” s’kanë fund. Në të vërtetë, në regjistrin e botuesve nuk figuronte shtëpi botuese me emrin “Alfa Mega” dhe korrespondenti i sjellshëm, Silvio Morales, s’kishte dëgjuar kurrë për ekzistencën e saj, megjithëse libri është publikuar, pra ekziston dhe aq më shumë ai,

Moralesi, e kishte lexuar dhe e vlerësonte si shumë interesant. Bioj Kasaresi nuk pati mundësinë të përgjigjet. Kishte ndërruar jetë në kohën kur letra ime, së bashku me shumë të tjera fluturoi mbi Atlantik për t'u bashkuar me procesionin e trishtuar epistolar, të cilat për inerci mbërritën në adresë njëfarë kohe pas vdekjes së adresuesit. Në njëfarë mënyre është mirë që dorëshkrimet e gjetura të autorëve anonimë të botohen nga shtëpi botuese që s'ekzistojnë. Por unë prapë s'mund të mos bëj pyetjen: “Zemra e Tokës” mos është i pari në radhën e precedentëve? Mos ndoshta, me librin që i ofrojmë lexuesit kureshtar gjithçka është në rregull? Mos po kërcet diçka e kobshme në vetë strukturën e realitetit, në zinxhirin përrallor shkak-pasojë-shkak, i cili po fillon të këputet, duke ndarë përfundimisht tregimtarin nga tregimi, tregimin nga e rrëfyera, botën nga imazhi ynë për të?

S. B.

Adolfo Bioj Kasares

ISHULLI I LARGËT

Parathënie e botimit argjentinian
të “Zemrës së Tokës”

Botimi i dorëshkrimeve të gjetura rastësisht i ofron vëmendjes së lexuesve edhe një titull, studimin “Zemra e Tokës”, kushtuar detajeve të panjohura nga biografia e Fridrih Niçes. Ky është një libër me një histori kontradiktore, po aq sa dhe përmbajtja e tij. Misteri që e mbulon këtë vepër, e bën transparencën e anonimatit të autorit edhe më të padepërtueshme. Krejtësisht jashtë tipikes së epokës, shkrimtari sikur ka bërë ç’është e mundur për dështimin e të gjitha kërkimeve lidhur me identitetin e tij. Si do të tregohet në vijim, libri nuk ka qenë i caktuar për publikim. Vetëm rasti (apo dora e Zotit) ka arritur ta shpëtojë dorëshkrimin nga harresa e plotë.

Tregimi për “Zemrën e Tokës” fillon në vitin 1996 në Qipro, më saktë në tokën asnjëse midis pjesës së pushtuar të ishullit dhe asaj të njohur ndërkombëtarisht, të kontrolluar nga forcat e Kombeve

të Bashkuara. Atë ditë, rreshteri Dijego Vargas Dijas, i batalionit argjentinasi pranë UNFICYP-it¹, duke mos pasur asnjë parandjenjë, po kryesonte patrullën në një kontroll rutinor të sektorit B, jo shumë larg Famagustës. Papritur toka nën këmbët e tij rrëshqet dhe ai bie në një shpellë të nëndheshme, njëra nga të shumtat në terrenin poroz gëlqeror të ishullit. Rreshteri Dijas ndez llambën me bateri dhe përballet me një pamje fantazmash. Më vonë do të provojmë ta përshkruajmë. Ndër sendet e shumta gjen dhe një dorëshkrim, prej rreth dyqind faqesh, i shkruar në një gjuhë të panjohur. Kishte një rrethanë fatlume! Sepse në atë kohë komandant i batalionit argjentinasi ishte koloneli Ignasio Garsija Valdekasas, bibliofil, biri i mikut të Borgesit, profesorit të filologjisë klasike, Marija Garsija Valdekasasit, i cili njihte fiksimin tim pas dorëshkrimeve të gjetura të humbura, të djegura, të lëna pas dore dhe fiktive. Koloneli Valdekasasi me mirësjellje ndoshta deri diku kundër rregullave (çka e bën edhe më të çmuar gjestin e tij) është përkujdesur për fotokopjimin e dorëshkrimit dhe dërgimin e tij me postën diplomatike në adresën time në Buenos Ajres, bashkë me shënimin e gjatë për kërkimet që kanë vijuar më pas.

¹ Një nga misionet paqeruajtëse më të gjata të OKB-së. Ai u krijua në vitin 1964 për të parandaluar luftimet e mëtejshme midis komuniteteve qipriote greke dhe qipriote turke në ishull dhe për të sjellë kthimin në kushte normale. (Shën. i përkth.)

Nga shënimet e kolonelit, në të cilat ndihej nostalgjia për Borgesin, kuptohet se shkak për kërkimet nuk ishte vetë dorëshkrimi, por sendet e gjetura pranë tij. Bashkangjitur edhe një listë si vijon: katër bomba dore për sulm - prodhim kinez; një makinë shkrimi “Remington” me tastierë cirilike; disa kuti bosh konservash të supës “Cambell’s”; ekzemplari “Zohara” në gjuhën hebraike; një pistoletë e vjetër me tytën e përthyer në 90 gradë ndaj boshtit horizontal; një tufë me para jugosllave të kohës së superinflacionit me bankënota prej 100.000.000.000 dinarësh; një libër me citate të Mao Ce Dunit; fotografia e njohur e Fridrih Niçes, Lu Salomesë dhe Pol Resë fotografuar në vitin 1882 në Romë, dhe në fund - ajo që shkaktonte një rrëqethje të vërtetë - një skelet njeriu krejtësisht i ruajtur.

“Tërë ajo skenë, - shkruan kolonel Valdekasasi, - i ngjante një veprë skenografike të përbashkët të një misterit të çuditshëm të Antonin Artaud, gjeneralit Pinoçet dhe Andy Worhol. Kockat, 206 copë gjithsej, ishin vendosur në mënyrë pedante, sikur të prisnin doktorin Nikolas Tulpa për të mbajtur një leksion të anatomisë së fantazmës.” Nga letra e Valdekasasit më tej informohemi se, sipas rregullave, kockat janë dërguar në Laboratorin e Mjekësisë Ligjore në Nikozia, që të identifikohet nëpërmjet analizës së ADN-së se kujt i përkisnin. Rezultatet kanë ardhur shumë shpejt, por konfuzioni bëhet edhe më i madh. Këto rezultate, në njëfarë kuptimi, janë verifikim shkencor i projektit

të kOBSHëm të “Zemrës së Tokës”: ndër 206 kocka nuk janë gjetur as dhe dy me të njëjtën ADN. Disa prej tyre s’kishin fare ADN! Të tjerat, datonin prej më shumë se një mijë vitesh. Por, prapëseprapë, të marra së bashku, formonin perfekt figurën e një burri mesatar, i gjatë 1.75 cm. Mbizotëronte mendimi se bëhej fjalë për një shaka pa kripë. Por skeleti është skelet: procedura duhet të çohet deri në fund. Në skenë dalin mjekët ligjorë. Ata po skanojnë kafkën dhe përmes imazheve kompjuterike arrijnë të rindërtojnë fytyrën. Ajo fizionomi fantomi, e krijuar nga kockat e njerëzve të panjohur, më vonë shumëzohet në disa kopje dhe vendoset në vende publike me shpresë se dikush do të njohë personin në foto. “Kalojnë ditë! - shkruan kolonel Valdekasasi. - Kalon një javë! Kalon edhe një tjetër! Çështja bie në harresë. Por, papritur, një mëngjes e përditshmja “Cyprus Mail”, e cila del në anglisht, publikon në faqen e parë lajmin sensacional: **NIÇE I VRARË NË QIPRO! HETIMI VAZHDON!**

“Por, ja çfarë kishte ndodhur: Si kudo në botë, një natë vonë, disa të rinj të pacipë, duke u kthyer nga diskotekat dhe klubet, u zbavitën duke i vënë dhëmbë vampiri dhe mustaqe portretit në pllakat. Me mustaqet e vëna, portreti i fantazmës bëhet i njohur. Nuk ka dyshim! Ky është Niçja i pështyrë. Por, dimë se Niçja ka vdekur prej kohësh. Dhe ka pasur një vdekje të natyrshme. Dhe nuk ka qenë kurrë në Qipro. Ndërkohë, asnjëri nuk pyet sot për faktet kur e paprovuara është më se e vërtetë.

“Shumë shpejt lajmi tërheq vëmendjen e sëmurë të të gjithë atyre revistave të mjera, të cilat merren me pjata fluturuese, fantazma, shpirtra të rilindur, profeci, me shqisa të gjashta dhe parashikime mashtruese, si dhe publikojnë shkrime, fryt i fantazisë së shfrenuar të tmerreve. Nuk mbetet mbrapa as shpirtligësia e komercializimit. Emri i Fridrih Niçes dhe e ashtuquajtura vdekja e tij e dhunshme në Famagustë po përfshihen në ofertat turistike të Qipros. Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë del me një njoftim ku dënon ashpër përbaltjen e kujtimit të filozofit të madh. Vetëm pas disa muajsh, etja për sensacione të reja lë pas aferën Niçe dhe ajo zhytet përsëri në harresë.”

Kështu shkruante Valdekasasi. Por, në tekstin e “Zemrës së Tokës” ka mjaft prova bindëse për qëndrimin e Niçes në Qipro. Ashtu si nuk ka harta gjeografike pa njolla të bardha, s’ka dhe biografi pa boshllëqe të pashpjegueshme. Një e vërtetë e pakundërshtueshme është se në biografinë e Niçes ekziston një boshllëk, i cili mund të mbushet vetëm me rrëfimin e autorit anonim. Prej këtij rrëfimi përsëri dëshmohet se Niçja ka ardhur në Qipro në përpjekje që të çlirohet nga ndikimi i kOBSHëm i Riçard Vagnerit. Për këtë ka të shkruara vëllime të tëra studimesh, por në asnjërin prej tyre nuk thuhet asgjë për tre muajt që mungojnë në jetëshkrimin e filozofit. Ndërkohë “Zemra e Tokës” i drejtohet pikërisht dhe vetëm asaj

periudhe, asaj kohe të humbur, pa marrë parasysh morinë e fakteve të njohura publikisht.

Vetë Niçja sjell në shkrimet e tij fakte të shumta që dëshmojnë për raportet e komplikuar midis tij dhe kompozitorit të madh. Rugës zbulon sekretin e “madhështisë” së Vagnerit. “Ah, ai magjistar i vjetër! - shkruan në një nga esetë e tij Niçja. - Si na mashtronte vetëm! Gjëja e parë që ofron arti i tij është xhami zmadhues. Nëpërmjet tij, ti shikon dhe s’u beson syve: gjithçka duket e madhe - edhe vetë Vagneri.” Pra, një mashtrim optik. Përveç kësaj, ajo që e tërheq vëmendjen e Anonimit është dhe projekti i Niçes për mesdhetarizimin e muzikës, me të cilën filozofi kërkon të largojë kompozimin nga temat pseudomitologjike dhe pagane në drejtim të freskisë mesdhetare të muzikës për hir të muzikës, të melodive të gëzuara, të spastruara nga mistifikimet, të cilat Niçja i quan dekadente. Është e qartë se një projekt i tillë nuk mund të realizohej duke pasur Vagnerin afër. Por fatkeqësisht, në Europë, kudo që të ishte Niçja, Vagnerin do ta kishte gjithmonë afër. I kudondodhur! Ai në të vërtetë nuk është kompozitor. Ai është revolucionar. Apo më mirë të themi: kundërevolucionar. Ashtu si del, Niçen nuk e kanë lexuar mirë. Apo qëllimisht s’e kanë lexuar mirë. Në të vërtetë, është ai që mbron vlerat tradicionale europiane; ndërsa Vagneri është ai që i hedh poshtë. Në mënyrë tinëzare. Irracionale. Duke krijuar efekte të kobshme të nënvetëdijes përmes muzikës së tij.

“A është Wagneri, në tërësi, një qenie njerëzore? - bën pyetjen Niçja. - A s’është ai më shumë një sëmundje? Gjithçka që ai prek sëmurët. Ai edhe muzikën e bënte të sëmurë!”

Roli i muzikës së Vagnerit në ngritjen e nazizmit jo vetëm se nuk është parë seriozisht, por hidhet poshtë si një absurd. Megjithatë, nëse bëjmë një analizë serioze pa marrë parasysh besëtytnitë e epokës, nazizmi - së bashku me kataklizmën e tij: llogoret e vdekjes, shkatërrimet dhe megalomaninë - nuk është asgjë tjetër veçse një opera në të cilën tingujt e violinës, të instrumenteve frymore dhe goditëse, zëvendësohen me gjësimin e topave. Simfoni e vdekjes e luajtur nga një orkestër muzikantësh të shurdhër. “Zemra e Tokës” është në themel, libër për zanafillën e nazizmit. Për daljen e paevitueshme të tij në skenën historike. Anonimi kërkon të vërtetojë se Niçja, i cili në fillim ka qenë një adhurues entuziast i muzikës së Vagnerit, kupton më vonë se ajo në fakt nuk ishte art, por një politikë gjermanike dhe me parandjenjën se faji për atë që mund të ndodhë, do t’i ngarkohet atij të niset për në Qipro për të larë hesapet me Vagnerin. Nga teksti i “Zemrës së Tokës” marrim vesh se atje ai mban shënimet në manshetat e këmbës. Ishte i detyruar të vepronte kështu. Wagneri zotëronte kopjet magjike të shtypit evropian; çfarëdo që të shkruante do të dilte në të. Për t’u mbrojtur nga Wagneri i gjithëdijshëm, Niçes i duhet të shkruajë turqisht. Në një nga manshetat e tij shënon fjalët: “Sot, ndoshta

asgjë nuk është më e njohur ose të paktën e studiuar thellë si karakteri biologjik i degjenerimit që fshihet në kapsulat e artit dhe artistëve. Mjekët dhe fiziologët tanë kanë për të gjetur te Vagneri rastin më interesant, sepse në fakt asgjë nuk është më moderne sesa ajo sëmundja absolute, ajo vonesë dhe tensionimi i mbisforcuar i mekanizmit nervor. Vagneri është një artist modern *par excellence*, është Cagliostro i moderimit. Gjithë çfarë kërkon bota është e përzier në artin e tij në një mënyrë krejtësisht mashtruese - përmes tre stimuluesve të fuqishëm të shkatërrimit: brutaliteti, popullariteti dhe idiotizmi.”

Çfarë tjetër është nazizmi në mos ajo treshja e mbështjellë me flamurin e kuq dhe kryqin me grepa në të, e rrethuar nga teli me gjemba?

Me të vërtetë mund të thuhet - me disa përjashtime - se filozofia gjermane, letërsia dhe muzika e shekullit XIX nuk janë asgjë tjetër veçse një fushatë elektorale e NRPN-së¹. Gjatë një shekulli të tërë, librat, koncertet dhe operat kanë krijuar një gjendje shpërthyesë të shpirtit. Më vonë do të mjaftonte që dikush, kushdo qoftë ai, pa asnjë arsye të veçantë, madje dhe për habinë e vetë Fyhrerit të ardhshëm, të hipte në tavolinën e një pijetoreje periferike dhe të

¹ Non-Registered Parameter Number - Numri i parametrut të paregjistruar (NRPN) është pjesë e Interfejsit Digjital të Instrumentit Muzikor (MIDI) për kontrollin e instrumenteve muzikore elektronike. (Shën. i përkth.)

thërriste: “*Heil Hitler!*”, për t’iu përgjigjur miliona britma:

“*Sieg Heil!*”.

Por, le t’i kushtojmë pak vëmendje Anonimit dhe veprës së tij. Pa dyshim këtu bëhet fjalë për njëfarë gjeniu anonim. Sepse, pa emër, i panjohur, i fshehur, ai përherë gjen mënyrën të tërhiqet dhe të zhvillojë edhe më shumë anonimitetin. Çdo gjë që për një çast po tërheq vëmendjen tonë, njëkohësisht na largon edhe më shumë prej atij vetë. Nga *Parathënia* apo Shkalla qipriote e tmerrit, po kuptojmë se ka qenë në Nikozia gjatë vitit 1995, si një nëpunës i thjeshtë, me siguri i një sektori që nuk ekziston, i Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH). Në këmbënguljen e saj për të njohur identitetin e autorit, redaksia e shtëpisë botuese “Alfa Mega” iu drejtua me një letër kortezie sektorit të Personelit pranë OBSH-së me kërkesën që t’i dërgojnë listën e personelit që ka punuar në Qipro në vitin 1995. Përgjigjja ka ardhur shumë shpejt. Një fletë letre pa emër, me një ton të ftohtë lajmëronte redaksinë se sektori nuk mund t’i përgjigjej kërkesës së “Alfa Megës”: “Nuk janë të autorizuar!”. Dyshimet e anonimit për ekzistencën e organizatës në të cilën punon - frikësuese në shikim të parë - si duket nuk janë fare pa bazë. Po bëjmë pyetjen: a është ajo organizatë shëndetësore apo shoqëri sekrete? Mos është koha e inversionit ku anëtarët e lozhave masone dhe shoqërive ezoterike kërkojnë publicitet, ndërsa Kryqi i Kuq dhe organizatat distributore të lodrave të

përdorura fshihen pas perdes së padepërtueshme të së fshehtës?

Ka një ngjasim midis Qipros dhe Tlön Uqbar-it¹. Nga këndvështrimi gjeologjik, trualli i ishullit është nga më të vjetrit në botë. Jo rrallë këtu zbulohen gjëra të çuditshme, të cilat nuk i gjen në pjesën tjetër të botës. Përsëri, me të gjithë respektin ndaj kujtimit të Borgesit, s'mund të themi se “Zemra e Tokës” është *Hronir*, vepër pa autor, libër i shkruar thjesht nga nevoja për një lexim të tillë. Nuk ka dyshim se në të mund të ndeshet edhe ndonjë enë e vogël alabastrit apo figurinë e prodhuar thjesht prej tij, por pas çdo libri qëndron një njeri. Por, kush është ai? Dhe ku ndodhet tani? Kërkimi i përgjigjes së kësaj pyetjeje - që fatkeqësisht do të jetë pa fryte - na çoi në veri, në pjesën e pushtuar të Nikozisë dhe deri diku na shtrëngoi të shkelim të drejtën ndërkombëtare, madje edhe më shumë, të hyjmë në konflikt me vetë realitetin, sepse të ashtuquajturën “Republika Turke e Qipros së Veriut” nuk e ka njohur askush, kurse për vendet të cilat nuk janë anëtare të OKB-së, si rrjedhojë, nuk ekziston. Në *Parathënien* e tij, autori anonim përmend disa personalitete të cilat duke mos qenë të trilluara, mund të ndihmojnë për zbulimin e identitetit të tij. Kërkimet e kujdesshme (një ndihmë të çmuar ndërmjetësimi kanë dhënë vëllezërit e

¹ Tlön, Uqbar, Orbis Tetius, ese nga Jorge Luis Borges, Buenos Aires, 1944. (Shën. i përkth.)

Borgesit nga Stambolli) më në fund japin rezultat. Pavarësisht se shteti në të cilin jetojnë është fiktiv, dr. Niqmet Jolçu dhe profesoresha Tansu Talat janë persona realë.

Por, duket se Anonimi nuk është real.

Çfarë konkluzioni tjetër mund të nxirret nga letra e gjatë e dr. Hiqmet Jolçusë? Ai njofton se i ka lexuar me vëmendje ato pjesë të tekstit ku përmendet emri i tij. “Shumica e të dhënave të biografisë sime janë plotësisht të sakta. S’e kam idenë si janë bërë të njohura për shkrimtarin, - shkruan ai. - Por, të tjerët janë thjesht trillime. Unë vërtet e kam njohur pak shoferin e OBSH-së, i cili u prezantua si serb dhe sillte herë pas here në klinikën time pako modeste ilaçesh. Për sa më kujtohet, atë mistifikator e quanin Xho. Unë nuk besoj se ky ishte emri i tij i vërtetë. Por asnjëherë nuk kam pasur ndonjë bisedë të gjatë me të. Aq më pak ta kem shoqëruar në ndonjë vizitë në pavijonet ‘e fshehta’ të spitalit ku punoj. Aq më pak se në këto pavijone nuk ekzistojnë sëmundjet fantastike për të cilat flitet në libër. (Këtu kemi sëmundje ‘të zakonshme’.) Ndërsa për miqësi, për mbrëmje të kaluara bashkë e të tjera të kësaj natyre, as që mund të flitet. S’dua të lë përshtypje të njeriut mendjemadh, por Qiproja, sidomos pjesa veriore, është akoma një ambient patriarkal, prandaj është krejtësisht e pamundur që një mjek dhe një shofer të rrinë bashkë në një tavolinë. Në fund, dhe jo më pak e rëndësishme, fjalët e atij gënjeshtari se mujezini i

dehur më paska prerë gabimisht penisin kur më ka bërë synet, është një trillim i ulët dhe unë me gjithë zemër ju uroj të zbuloni identitetin e tij që edhe unë ta takoj atë njeri të paturp dhe të marr hak. Vetëm gjaku e lan njollën e emrit tim.”

Pra, Xho! Por Xho është një nofkë e KUJTDQ.

Letra e profesoreshës Tansu Talat i jep disi ngjarjes një përshkrim tjetër. Ekziston mendimi se gratë - kur s'është fjala për to - gënjejnë shumë më pak se burrat. Lind pyetja se sa mund t'i mbështetemi këtij psikologjizmi. Në fund, lind pyetja se sa mund t'i mbështetemi dëshmisë së kujtdo qoftë, që, të paktën dhe për pak kohë, ka qëndruar në atë ishull të largët duke u ballafaquar vazhdimisht me realitetin. Por nuk kemi burime të besueshme. Profesoresha Talat nga natyra nuk ka komplekse të tredhjes. Mbase prandaj është dhe dashamirëse ndaj Anonimit. Ajo gjithashtu e njeh me emrin Xho. Po ashtu mendon se doktor Jolçu e tepron. Ka lexuar përkthimin e bashkangjitur dhe mendon se këtu është fjala për një *fiction*, për një roman, ku për hir të autenticitetit, përfshihen dhe persona realë. “Në përgjithësi, - shkruan zonjusha Talat, - publikimi i ‘Zemrës së Tokës’ ka një rëndësi të paçmuar, jo vetëm për temën kryesore - i ashtuquajtur qëndrim i Niçes në ishull - por dhe për faktin se në këtë studim për herë të parë përmenden banorët autoktonë të ishullit, fisi i lashtë Hurubu, për ekzistencën e të cilit deri vonë s'dihej asgjë në botë.” Ajo, Tansu Talat, personalisht e ka shoqëruar Anonimin deri në krahinën e fshehtë, banuar nga Hurubët.

Tansu Talat, përveç atij udhëtimi te vendbanimi i vendasve, e ka takuar shkrimtarin e “Zemrës së Tokës” edhe disa herë të tjera, por gjithnjë në shoqërinë e Vanjës së famshme, nëpunëses së OBSH-së, me të cilën ishin miqësuar. “Çfarë mund të them për atë njeri? - shkruan në letër. - Për çudi kam harruar krejtësisht sesi dukej në përgjithësi. As nuk më kujtohet të ketë folur. Sigurisht, një pamje do të ketë pasur dhe është e pamundur të mos ketë thënë diku asgjë.”

Si përfundim, me kohën çdo kërkim sjell si rezultat diçka të re. Në rastin tonë ndodhi krejt e kundërta. Sa më të mëdha ishin përpjekjet në kërkimet për shkrimtarin e ‘Zemrës së Tokës’, aq më larg ishim nga qëllimi ynë, aq më shumë e humbim atë në thëniet kontradiktore të njerëzve që e kishin njohur. Po qe se Ky ishte me të vërtetë Ai... Me të këtillë asnjëherë s’i dihet. Në fund, prova e vetme reale mbetet fotoja e sendeve të shpellës ku u gjet dorëshkrimi. Unë gjithnjë e më shumë po bindem se ato sende nuk ishin rastësisht bashkë, se ato janë në të vërtetë një rebus, ose e thënë me fjalorin modern - një instalacion, inskenim metakonceptual ku teksti i “Zemrës së Tokës” është çelësi i deshifrimit.

I mbetet secilit prej lexuesve ta provojë të zgjidhë misterin.

Buenos Ajres, 1997

PARATHËNIE

ose

Shkalla qipriote e tmerrit

*Por këta, të dërguarit e Shpirtit të Shenjtë,
uleshin në Selevkije dhe niseshin për në Qipro.*

Pjesa apostolike,13:4

*Qielli është i rrethuar nga vuajtja, ferri është
i rrethuar nga kënaqësitë.*

Al Ghazali

Në vjeshtën e vitit 1995, me rekomandimin e një miku me peshë, sigurova punën e përkthyesit pranë delegacionit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila duhet të realizonte një studim për rastet shëndetësore në pjesën e pushtuar të Qipros Veriore. Vitet e kaluara me studimin e orientalistikës, të cilat i kisha quajtur të humbura, më në fund treguan se nuk ishin të padobishme, megjithëse, ndërkohë, kisha harruar turqishten. Përveç, sigurisht atyre dy-tre mijë fjalëve të cilat osmanlinjtë, duke u tërhequr nga Ballkani i lanë në fjalorin e gjuhës sime amtare

si plaçkë lufte. Por rasti e solli që kjo të mos përbënte ndonjë problem. Shefi i delegacionit, dr. Van der Mer urdhëroi, që bisedimet midis zyrtarëve qipriotë turq dhe anëtarëve të delegacionit të zhvillohen në anglisht. Ky Van der Meri! Që nga fillimi nuk më shihte dot. Por Statuti i OBSH-së parashikon vendin e punës të përkthyesit zyrtar dhe ai s'kishte ç'të bënte. Me të mbërritur në Nikozia, në mbledhjen me rastin e ndarjes së punës, foli shkurt ndër dhëmbë: "Për efikasitet, bisedimet do të zhvillohen pa ndërmjetës. Por njohuritë tuaja do të jenë të dobishme me rastin e vizitave në dispanseritë e fshatit të lëna pas dore, atje ku njerëzit nuk flasin gjuhë të huaja."

Kam kohë që nuk punoj më për OBSH-në, edhe pse me kushtin që është ende në fuqi, tashmë nuk jam i detyruar t'i qëndroj besnik. S'ka pasur asnjë lloj vizite në dispanseritë e fshatit. As që ishin të parashikuara. Gjithçka përmbliidhej në vizitat jo dhe aq të shpeshta dhe të zgjatura nëpër spitalet e qyteteve të mëdha: në Famagustë, Kerinji dhe Morfu. Kohën tjetër secili e kalonte sipas qejfit. Unë mblidhja sende të ndryshme, mbaja shënime për studimin mbi Niçen dhe përpiquesha të mësoja sa më shumë për ishullin në të cilin kisha ardhur me njohuri të cekëta për historinë e tij: Se ka qenë koloni angleze. Se gjatë viteve pesëdhjetë, nën udhëheqjen e arqipeshkv Makariosit, EOKA'A ka bërë një luftë çlirimtare. Se ka fituar pavarësinë në vitin 1960. Pastaj vjen

EOKA'B¹, planet për bashkim me Greqinë, konfliktet e para ndërkomunitare, tentativa për puç dhe në fund pushtimi i ushtrisë turke dhe okupacioni i pjesës veriore të ishullit në të cilën më vonë, e panjohur prej kurrkujt, u krijua Kuzey Kibris Turk Xhumhuriyeti - “Republika Turke e Qipros Veriore” - emri i së cilës nën ndikimin e lobit linguistik grek, në drejtshkrimin e shumicës së gjuhëve (përveç turqishtes, arabishtes dhe kinezishtes) detyrimisht vihet në thonjëza ².

Për t’u distancuar, në atmosferën e tensionuar si rezultat i simulimit të pandërprerë të shkujdesjes dhe përzemërsisë mes personelit, lashë mustaqe të trasha niçeane. Kjo e përforcoi edhe më shumë intolerancën e Van der Merit ndaj meje. Në sistemin referencial politik dhe korrekt, pra: të njerëzve të hiperorganizuar, të dobët dhe frikacakë, mustaqet janë shenjë rebelimi. Simbol i burrërisë. Shprehje e mosbindjes. Mustaqet janë kufiri; vija e cila ndan Europën e rruar, të kulturuar, prej botës së tretë, të koklavitur, të ngatërruar.

¹ Organizatë paraushtarake greke qipriote e formuar në vitin 1971. (Shën. i përkth.)

² Mbetet interesante që presidenti i parë i huaj që ka vizituar Qipron menjëherë pas pushtimit ka qenë presidenti i atëhershëm i RSFJ-së, Josif Broz Tito. Në “Platea Elefterias”, tregu kryesor në Nikozia, ende qëndron pllaka e gurtë, në të cilën është shkruar në greqisht, me shkronja kapitale, disi të fshira: “Në këtë vend presidentët Makarios dhe Tito i kanë folur popullit të Qipros.”

Van der Meri nuk humbiste rast që këtë të ma plaste në fytyrë në mënyrën e tij të përsosur jonjerëzore. Ndërkohë sarkazmat e tij nuk binin në shenjë. Mustaqet ishin pritë dhe absorbim. Unë i qesh ëmbël pas barrierës së sigurt të qimeve. Ai e di këtë. Por nuk e sheh dot. Ndërsa ajo që nuk shihet, nuk ekziston.

Duke pasur kohë të bollshme të lirë, po filloj të shtjelloj historinë e shtresave misterioze, pothuajse mistike të “kontinentit të vogël të Mesdheut Lindor”, siç e quan Qipron me stilin e tij të rafnuar, Fernand Braudel. Po t’i hedhim një sy të kaluarës, do të shohim se që nga kohërat më të vjetra gjeologjike asgjë nuk është njësoj, nuk është e njëjtë, kompakte. Sipas kërkimeve paleontologjike, në kohën e lashtë ka pasur dy Qipro. Sot ato janë dy kurorat e maleve, Troodosi dhe Pentadaktilos, njëra në veri dhe tjetra në jug, që shtrihen në drejtim lindje-perëndim. Në fotot satelitore duket qartë se këto janë dy masive krejtësisht të ndryshme - i pari do t’i ketë takuar përpara Rodopeve, ndërsa i dyti Dolomiteve - të lidhur detyrimisht me pllajën e gjerë gëlqerore që ngrihet nga fundi i detit me një pështjellim të fuqishëm tektonik. Aleksandri, inxhinier gjeologjie nga Novi Sadi, i cili punon si kamerier në kafe “Epi Topoy” në qendër të Nikozisë Jugore, e konfirmon atë hipotezë. “Nuk ka asnjë dyshim, - thotë ai, - masivi i Troodosit i takon kontinentit aziatik; Pentadaktilos është fundi i kurorës së maleve dinarike. Fusha që i lidh përbëhet nga sedimente. Përfundimisht Qiproja

nuk është një tokë kompakte.” Kësaj i duhet shtuar edhe një e dhënë gjeografike e re: në një sipërfaqe të përgjithshme prej 9.125 kilometrash katrorë, 1.350 kilometra katrorë janë fusha të minuara.

Nga jashtë, është diçka paradoksale, por gjithçka duket më bukur sesa nga afër. Nën lupë fotografitë satelitore tregojnë ndarjen e kujdesshme të vargmalit. Pentadaktilos i është në territorin e pushtuar, shiko çfarë rastësie. Troodosi është në territorin grek. Gjeologjia shkrihet me gjeopolitikën. Dëshirat njerëzore përkojnë me vektorët e forcave sizmike. Në vendet e vogla hapësira e kufizuar i shtyn njerëzit t’i zgjerojnë artificialisht, duke ëndërruar. Trashëgimia e së kaluarës së vështirë është ajo që i bën ta përdorin gërhërën dhe ngjitësin për ta bërë më të bukur. Prodhimet e shtëpive botuese të Qipros çdo vit hedhin në treg një numër të frikshëm librash në të cilat provohet se ishulli është në të vërtetë një mbetje e Atlantidës së lashtë. Libra, në të cilët me fotot e peizazheve me të vërtetë jotokësore të ishullit, hidhet poshtë teoria sipas së cilës lugina Mezaorija është një fund deti i lartë, në favor të hipotezës se është pasojë e rënies së meteorit gjigant. Këta libra, sikur të mos u mjaftonte pushtimi, shkatërrimi i luftërave të përgjakura, po sjellin në truallin e ishullit dhe Luftën e Trojës duke e lokalizuar në ato vende të cilat më së shumti përkojnë me vendin e lindjes së autorëve. Pas leximit të teorive përçarëse, unë, me intuitë dhe imagjinatë, po filloj të konceptoj fatin e ishullit të

lidhur në mënyrë të pazgjdhshme me fatin e banorëve të tij. Bregu verior është larg bregut të Anadollit nga gjashtëdhjetë kilometra; ai i jugut diçka pak më shumë nga bregu i Azisë dhe i Afrikës. Në kohët antike, dijet kartografike nuk kanë qenë precize, largësi të tilla shpeshherë u shpëtojnë dhe Qiproja nganjëherë zhduket në mënyrë misterioze. Po lë pas vetes një det të hapur. Në dokumentet tregtare të vendeve përreth nuk përmendet për plot 180 vjet; Troodoisi dhe Pentadaktilos i ngrihen mrekullisht pranë malit Ararat në kufi me Turqinë e sotme dhe Armeninë. I shohim qartë në hartat e prijësve të karvanëve të përdorura prej tyre në Rrugën e Mëndafshit. Ndoshta kështu shpjegohet prania e konsiderueshme e komunitetit armen në ishull. Herë tjetër, këto male bredhacake i gjejmë thellë në shkretëtirën e Sirisë. Në kërkimet e tyre në Qipro arkeologët kanë gjetur gjurmë të kulturës materiale të Palmirit. Ne nuk dimë asgjë sesi dukej bota para një mileniumi. Toka është një qenie e gjallë. Në qoftë se malet, lumenjtë dhe rrafshnaltat në kohën e re janë pak a shumë në vendet e tyre, kjo nuk është shenjë e stabilitetit.

Ajo është shenjë e pleqërisë.

Është mbresëlënëse lista e njerëzve të shquar që kanë ardhur në Qipro. Llazari, ai që Krishti e ngriti nga të vdekurit, ka qenë peshkop në Qipro. Këtu ka vdekur përfundimisht për herë të dytë. Është varrosur në kriptën e kishës “Shën Llazari” në Larnakë. Pas tij, ndoshta dhe para tij, duke pasur parasysh

distancën kohore, radha nuk është dhe aq e qartë, vjen Shën Pali për të filluar misionin e tij në Salaminë mes të pafeve. Në Limasol ekziston sot e kësaj dite kështjella në të cilën Rikard Zemërluani ka vënë kurorë me Berengarijen. Por mbërrin prej diku edhe Omar Khajami për të degustuar verën e famshme të Komandarijes. Leonardo da Vinçi ka ardhur për punë objektive: për të porositur në Lefkari, e njohur për dantellat më fine, mbulesa për katedralen e Sienës. Gjenu Artur Rembo ka qenë në Qipro në rolin e sipërmarrësit. Se sa e jashtëzakonshme ka qenë kjo ardhje, e shohim teksa mbikëqyr punimet e ndërtimit të rezidencës verore të guvernatorit britanik rrëzë malit të Troodosit.

Sot, në Qipro vijnë vetëm turistë, biznesmenë rusë dhe ekspertë të organizatave ndërkombëtare.

Ekipi i ekspertëve me në krye Van der Merin është i akomoduar në hotel “Hilton”, në Nikozinë Jugore. Personeli ndihmës, shoferë, përkthyes dhe sekretarë, midis tyre edhe unë, janë vendosur në hotel “Saray”, në veri. Kështu del më lirë. Nuk kam asgjë kundër. Duhet të ketë radhë. A nuk isha unë që në vitet shtatëdhjetë, nën ndikimin e librave të Evolit, botova një artikull në shtypin studentor, në të cilin ngrija lart sistemin e hierarkisë? Sot akoma besoj në të. Diçka tjetër më shqetëson. Mirë, përkthyesit dhe shoferët! Por sekretaret, përse? Që të gjitha janë këmbëgjata, të mbajtura, tërheqëse. Kuptohet se ku më shkon mendja. Sekretin ma zbulon njëra prej tyre, Vanja,

beogradase, e cila tashmë ka tre vjet që punon për OBSH-në. Me kontratë, si unë. Por unë s'kam për të punuar kaq gjatë. Vanja është njëra nga ato vajzat e shumta, që janë të bukura, të talentuara, inteligjente dhe që vijnë nga “familje të mira”, të cilat që të vogla e dinë se çfarë duan; të cilat ndjekin orët e pianos, kurset e gjuhëve të huaja; mbarojnë fakultetet në kohë, shumë shpejt rregullohen me punë jashtë shtetit të cilën e kanë lakmuar aq shumë dhe pjesën tjetër të jetës e kalojnë duke takuar, duruar dhe marrë atë çfarë nuk kanë dashur dhe prej çfarë kanë dashur të ikin. Ndoshta Niçes s'do t'i pëlqente, por Vanja lexon me pasion Zarathustrën. “Mos i thuaj njeriut, por ata të gjithë, të gjithë pa përjashtim, janë gei”, më thotë Vanja në mirëbesim një mbrëmje, kur ishim në restorantin e katit të tetë të hotelit “Saraj”.

E ka fjalën për pjesën mashkullore të delegacionit të OBSH-së!

Kështu po mendoja! Pederastë! Kjo i shpjegon të gjitha!

Pas uiskit të tretë, Vanja bëhet më e qartë. Më zbulon se po ky ekip lëviz nga një rajon krize në tjetrin. Bisedojnë me mjekë, vizitojnë spitale, mbajnë shënime, fotografojnë dhe kjo është pak a shumë e gjitha. Informacioni dërgohet diku. Ç'ndodh me atë informacion, s'dihet. Me siguri asgjë. *Por*, shton ajo, *merren vesh për mrekulli*. “Djem të sjellshëm, ndërkohë, të gjithë, nga i pari deri tek i fundit - gei!” Tashti është krejt e qartë melankolia e saj e fshehur

keq. Planet e saj kanë vijuar në trajektoren që ka pasur kuptim vetëm në fazën e përgatitjes. Pra: orë pianoje, kurse të gjuhëve të huaja, provime, në shtrat me disa djelmosha të fuqishëm, të cilët duhet t'ia hapin dyert e organizatave ndërkombëtare. Dyert përfundimisht hapen dhe ajo hyn në vëllazërinë e fshehtë të pederastëve, në rrethin vicioz, ku sipas ëndrrave të saj duhet të gjejë burrin e ardhshëm, por nuk gjen asgjë. I duhet ndoshta edhe një gjysmë viti, apo një i tërë, për të zbuluar, se këtu përveç shoferëve dhe ndonjë përkthyesi askush tjetër nuk interesohet për të dhe, para se të flejë, të ndiejë atë përzierje stomaku kur poshtë qepallave t'i kalojnë hologramet e atyre pleqve të plogët dhe të dhjamosur, rojat e portave të botës më të mirë, që i ejakulojnë në fytyrë.

Kështu vijmë tek uiski. Ajo që duhet të ishte simbol statusi kthehet thjesht në ansiolitik. Dhe hapet një tjetër derë pas së cilës shkallët zbresin deri në thellësitë e pamatshme të tmerrit. Dhe ja, turqizmi - mahmurlleku. Por, në botën ku ka rënë peng, mahmurlleku s'është mahmurllek, as *hangover*, por vetëm një tjetër nga kurthet e korrektesës politike - *drinking problem*. Në mëngjes sauna, pudër, grim, syze dielli, shtyrje të ndryshme orë pas ore të kohës së punës, në darkë përsëri uiski. Tani jemi tek e pesta. Vanja bën sikur nuk do, s'donte që me të parën, ndërkohë do të pimë edhe nja dy të tjera. Po marr vesh ndërkohë se Van der Meri (me dy "e" te mbiemri) dhe doktori i ri B'twongo janë dashnorë (*Van der Merit*,

thotë, *i pëlqejnë me ngjyrë*). Por B'twongoja e gënjen; që puna të bëhet tamam, dëshiron të bjerë në shtrat dhe me gra.

(Mendoj dhe me Vanjën). Van der Meri bën skena të përmbajtura xhelozie. Doktor B'twongoja ia kthen me goditje të ashpra. *Por*, thotë Vanja, *asnjëherë s'e godet në fytyrë*. Për korrektesë diplomatike. “Zezaku si gjithë zezakët...”, them unë. “Por në qoftë se do të isha pede dhe të isha në vendin e tij, edhe unë do të tradhetoja Van der Merin.” Vanja tmerrohet. Dy herë fjala “zezak”, një herë “pede”, plus emri i përmendur i Van der Merit. Kur është shumë, është shumë. E vë gishtin në buzë. Pëshpërit: “Mos guxo të flasësh kështu! Po dëgjuan, do të humbasësh punën! Ta dish, B'twongo flet shkëlqyeshëm serbisht. Ka studiuar në Beograd.”. Ajo ka frikë se mos dëgjojë B'twongo. Ai është larg disa kilometra që këtej, pas Vijës së Gjelbër, në “Hilton”, në shtetin e njohur. Ne të dy jemi në pseudohotelin “Saray”, në pseudoshtetin, siç u takon pseudonjerëzve nga pseudoshtetet e tjera, të largëta të Europës Juglindore. Ai është problemi i Vanjës. Kur je pseudo, je përgjithmonë pseudo. Ajo nuk pajtohet me këtë, prandaj është edhe më shumë pseudo.

Dalim në tarracën panoramike që rrethon restorantin. Në nëntor netët e Nikozisë janë edhe më të këndshme. Por ka diçka të pakëndshme në tërë pamjen. Në shikimin e parë nuk e kuptoj se nga vjen. I mbështetur në parmakun e tarracës, pakëz nën ndikimin e pijes, po ndërgjegjësohem se në Qipro,

përveç territorit, edhe drita është e ndarë. Pjesa e jugut e qytetit shkëlqen si një sallë operacioni. Menjëherë vjen vija zigzage e ndarjes e mbuluar me errësirën e ngrysur, prej këtej fillojnë rrugët e Nikozisë së Veriut në të cilat mezi duket drita e zbehtë e llambave, si ato të qyteteve ballkanase, që vetëm ndriçojnë veten e tyre. Drita që e bëjnë errësirën edhe më të padurueshme, sepse e bëjnë të dukshme. “Hajt shkojmë të flemë, - i them unë Vanjës. - Nesër është ditë pune!”

“Po, nesër është ditë pune”, thotë Vanja dhe hyjmë në ashensor. Para derës së dhomës së saj, si gjithmonë, mbajmë hapat; ajo më zotëron (sidoqoftë ajo është dama), më kap për krahu dhe propozon të pimë edhe nga një uiski në dhomën e saj. E dimë se ku i rreh. Mendohem për një çast dhe vendos: le ta pijë vetëm. Sikur propozimi i saj të ishte i motivuar nga pasioni, qoftë dhe nga dëshira e rëndomtë, kisha për të hyrë pa menduar. Por ky ishte një propozim nga dëshpërimi. Por bashkimi i dy dëshpërimeve sjell një dëshpërim edhe më të madh.

Nuk kthehem në dhomë, shkoj në katin e dytë, atje ku janë zyrat e delegacionit të lartë. Atje ndodhen kompjuterët dhe mrekullia teknologjike që në vendin tonë është ende e panjohur për njerëzit e thjeshtë - interneti. Por sajtet e shumtë të internetit janë obsesioni im i ri me fotot satelitore të sipërfaqes së Tokës. Këtu e kaloj pjesën më të madhe të natës, duke shfrytëzuar mundësinë, në atë kohë ishte akoma një privilegj, të shikoj Himalajet, Saharanë, Alpet. Perspektiva është absolutisht e ndryshuar. Pa

ndihmën e mjeteve teknologjike, ne, duke u ngritur një, apo dy metra lart nga toka, mund të shikojmë vetëm një projektion horizontal. Por kur hapësirën e skajshme e shohim të zvogëluar, nëpërmjet simbolikës fraktale, territori - hajt të përdorim personifikimin - tregon synimet e tij, natyrën e vet të vërtetë, të cilën shpeshherë, në një proces të kundërt të personifikimit, ia ngarkojmë njerëzve, që banojnë në këto hapësira. Dua të them se: ne shpeshherë sillemi sipas diktatit të gjeografisë. Netëve rri para kompjuterit dhe shoh në monitor fotografitë e panumërta satelitore. Tashmë i jap trajtë teorisë që kurrë s'kam për ta hedhur në letër, të tilla ka shumë - sipas së cilës, vlera dhe cilësia e jetës njerëzore është e kushtëzuar nga morfologjia e territorit. Në rajonet e parregullta, zakonisht sistemet politike nuk janë të qëndrueshme. Mjafton t'i hedhim një sy Kinës, nga ana e jugut mbështetet te masivi i Himalajeve, nga veriu, përsëri, është e kthyer drejt hapësirave të fundme të kontinentit aziatik, që qëndrueshmëria e saj, stabiliteti dhe jetëgjatësia të na bëhen të kuptueshme. Apo të marrim ish-Jugosllavinë, e cila edhe në kuptimin gjeologjik është një grumbull formacionesh të ndërsjella: Është Masivi Dinarik, i cili zgjatet drejt fushave të punuara panone dhe sllavone, përmes grykëmaleve boshnjake, pastaj vjen Shumadia, fushat e së cilës gradualisht rriten dhe bëhen kodrina, deri te kurora malore, që shkrihet me lartësitë malezeze. Në kuptimin antropologjik nuk është një vend i individit të qëndrueshëm. Terreni s'gënjën: Jugosllavia duhej të shpërbëhej.

Ashtu si flasin Troodosi dhe Pentaktilosi: Qiproja duhej të ndahej. Ashtu si teoria e Niçes që në fillim e ndau Gjermaninë në mbrojtës dhe kundërshtarë për të materializuar këtë ndarje përfundimisht me shpërbërjen në dy shtete. Ndërkohë nuk duhet të përjashtohet mundësia e kundërt. Dhe pikërisht se veçoritë psikologjike të banorëve, filozofia, feja e tyre, janë ato nga të cilat kushtëzohet konfiguracioni i krahinës në të cilën banojnë, si dhe vendi i tyre në historinë botërore.

T'i hedhim një sy relievit të Izraelit. Lind pyetja: A mund të lindte Krishti në një vend tjetër dhe të kryqëzohej në një vend tjetër?

Në këtë kohë dikush po hap derën. Në çast mendova se do të ishte shoferi Tadeush, polaku i moshës, pamjes dhe profesionit të papërcaktuar, dora e djathtë e Van der Merit. Spiun i vërtetë, të cilin e ndëshkoj kur ia shkruaj emrin Tadesh dhe jo Tadeusz, që për një polak është fyerje për vdekje, edhe atëherë kur nuk e di se ia kanë bërë. Ndërkohë, po hyn Vanja. Thotë se nuk e zë gjumi. Më pyet çfarë po bëj. Përgjigjet vetë: “Po merresh me internet!”. Më vjen nga pas, për të parë se çfarë po shikoj, mbështetet në shpatullat e mia në mënyrë miqësore, të pabezdisshme, por në mënyrë që gjoksi i saj të më prekë kurrizin. Nuk ia vlen të jesh modest në romancë, në qoftë se tashmë s’je në jetë. S’më mbetet asgjë tjetër veçse ta fik kompjuterin. Ta rrëzoj ëmbël në dysHEME. Të mbarojmë këtu atë çfarë ka ëndërruar të bëjë në shtretërit e mëndafshhtë të vilave luksoze mesdhetare.

Para se të mbarojmë, pëshpëriti: “Mos brenda meje!”. E dëgjova. U zbrazta në fytyrën e saj.

Rrethanat e sollën që të nesërmen të jem përsëri me Vanjën. Sipas versionit zyrtar, Tadeushi, i cili duhej të çonte Van der Merin, B’twongon dhe doktoreshën transparente Vordsvort te dr. Burhan Nalbantoglu, në Spitalin e përgjithshëm të Veriut, ishte sëmurur. Në fakt, falë simpatisë së shefit të delegacionit të lartë, ai po shfrytëzonte rastin të merrej me tregti. Blinte puro kubaneze, cigare amerikane dhe pije në *free-shop*-in e diplomatëve dhe pastaj ua shiste këto mallra dy herë më shtrenjtë tregtarëve vendas, të cilët i shisnin nën tezgë tri herë më shtrenjtë, dhe megjithatë tregtia lulëzonte, sepse në shitjen legale e gjitha kjo kushtonte më tepër¹. Në vend të Tadeushit,

¹ Sikur unë rastësisht t’u isha futur punëve të errëta, nuk ka dyshim që në atë rast do të më kishin kapur, do të më mbulonin me katran dhe pupla dhe në fund i varrë, ngulur në hu, në mes të “Platea Elefterias”, pranë pllakës përkujtimore, e cila përjetëson fjalimet e presidentëve Makarius dhe Tito. Me siguri, pas kësaj, ombudsmani do të nxirrte një njoftim të zbehtë, ndërsa grupet e idealistëve, që demonstrojnë përditë në favor të palestinezëve dhe të kurdëve do t’i kishin kushtuar ndonjë orë edhe rastit tim. Dhe me kaq çdo gjë do të kishte mbaruar. Ndërkohë Tadeushi, papenguar vazhdon punën. Por, Tadeushi është nga Polonia dhe Polonia është candidate për t’u pranuar në BE, ndërsa unë jam nga Serbia, e cila në ato vite ishte bërë sinonim i vetvetes: thjesht, thuhet Serbia dhe me këtë është thënë e gjitha. Pas asaj, heshtet.

u bëra unë shoferi. Por mua s'më pëlqen fare të ngas makinën. Aq më tepër me timon në të majtën. Ah, këta zaptues dhe kolonizatorë! Asnjëherë nuk largohen nga territori të cilin e kanë pushtuar njëherë. Ata lënë pas vetes grumbuj plehrash, miniera të shteruara, fëmijë jashtëmartesorë, fjalë të bastarduara, zakone të këqija dhe rregulla rrugore. Por çuditërisht, atë ditë, atmosfera në xhipin "Grand Cherokee", që ishte një automjet mjaft i madh dhe Van der Meri kishte kujdes për të mos më vështirësuar lëvizjen nëpër sokakët e ngushtë të Nikozisë Veriore, s'ishte fare e tensionuar. Madje disa herë Van der Meri tentoi të bënte shaka. Por me këtë vetëm sa e prishi predispozitën. Fatmirësisht, distancat në Nikozia nuk janë të mëdha: arritëm mjaft shpejt në spital. Në Qipro është në fuqi rregulli i mbetur nga koha e turbullirave: shoferët e organizatave ndërkombëtare qëndrojnë gjithë kohën në makinë ose në afërsi të tyre. Ky rregull do të më mundësonte nja dy orë të mira të lira. Mund të ndizja një cigare. Mund të lexoja diçka. Por Van der Meri kishte vendosur ndryshe. Më urdhëroi të marr nga kutia e ndihmës së shpejtë të makinës dy pako me aspirina "Bayer", një tjetër me vitamina C dhe t'i çoja në zyrën e drejtorit. Aty, para derës së drejtorit, bëri një ndryshim të vogël pune: B'twongoja dhe ai shkuan te drejtori; doktoresha Vordsvort, Vanja dhe unë, të shoqëruar nga doktor Hiqmet Jolçu, u drejtuam për vizitë në pavijonin e sëmundjeve infektive.

Doktoresha Vordsvort dhe Vanja e pritën detyrën me njëfarë entuziazmi. Në të vërtetë janë të trembura për vdekje. Unë, jo! E di se sëmundjet infektive nuk ekzistojnë. Ato “sëmundje” janë vetëm një nga metodat e stërholluara të kërcënimit. Ato “sëmundje” nuk vijnë nga jashtë. Murtaja përhapet thjesht me lajmin për epideminë. Por doktoresha Vordsvort dhe Vanja janë të sektit të maniakëve ku bakteret janë ngritur në piedestalin e pjellës së të keqes, kundrejt pjellës së dritës: ushqim i shëndetshëm dhe histeria antiduhan. Nuk ia vlen t’u shpjegohet se nuk mund të infektohen, veç nëse tashmë janë të infektuara. Nuk më bëhet vonë për kanadezen transparente. Vanja, prapëseprapë është diçka tjetër. Ajo është gjendur në këtë tmerr duke dashur t’i shpëtojë një tmerrit tjetër. “Shumë bukur!”, i them asaj.

“Shefi (nuk përmend emër që të mos tërheq vëmendjen e kanadezes) shkon për çaj te drejtori, ndërsa ti në pavijonin e sëmundjeve infektive.” Pastaj menjëherë i drejtohem anglisht doktor Jolçusë: “Mendoj se nuk është e nevojshme t’i keqtrajtojmë damat. Do të ishte e mjaftueshme ta kryejmë vizitën ne të dy.”. Jolçuja s’ka asgjë kundër. Madje tha se i vjen mirë. E lëmë doktoreshë Vordsvortën dhe Vanjën në mensën e spitalit.

Por në vend që të shkojmë drejt pavijonit të sëmundjeve infektive, tregimi merr një drejtim tjetër, krejtësisht të papritur.

Doktori Jolçu më drejtohet në serbisht! Me një theks fare të vogël më thotë: “Mendoj se është

më mirë t'u tregoj një pavijon tjetër interesant, të pakrahasueshëm!". Gjatë zbritjes me ashensor, Jolçu po shpjegon se si ai, megjithëse ka lindur në Edrene, flet shkëlqyeshëm serbisht. Deri në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar, prindërit e tij, myslimanë me origjinë sllovene, kanë jetuar në Bijello Pole. Jolçu, i ati, një argjendar besimtar, që në atë kohë mbante mbiemrin Alomeroviç, nuk pajtohej me progresin që pushteti komunist impononte me forcë. Nuk pajtohej se si në shkollë vajzat dhe djemtë do të rrinin bashkë: nuk kuptonte pse pushteti i ri ua ndalonte grave të mbanin çarçafin; ishte fyer nga sjelljet e disave (duke thelluar ndarjen midis tyre dhe myslimanëve) që në rrugë i merrnin festen nga koka dhe ia hidhnin në baltë. Edhe pse asnjëherë nuk kishte shkuar më larg se periferia e Bijello Poles dhe megjithëse tmerrohej nga çfarëdolloj udhëtimi, ndërsa udhëtarët i quante njerëz të korrumpuar (dhe kishte të drejtë), mori përfundimisht vendimin t'i bashkohej me familjen e tij emigrantëve që largoheshin për në Turqi. Atje, që në kufi, merr mbiemrin e ri Jolçu - shenjë e keqe, sepse në turqisht "jolçu" do të thotë atë që ai kurrë nuk dëshironte të ishte: udhëtar! Por ngushëllohet, sepse ndodhet në tokën turke. Është larg, në një distancë të sigurt nga të pabesët.

Të nesërmen e ardhjes së tyre, gruaja tij mbulon fytyrën me çarçaf, ai vë festen në kokë dhe ata dalin për herë të parë në një shëtitje në një qytet ku të gjithë janë myslimanë, në të cilin nuk ka kryqe dhe në rrugët

e tij nuk bredhin derra të pistë. Rasti e sjell, pas disa hapash, të ndeshen me një patrullë policie. Babë Jolçu nuk di asgjë për reformat e Qemal Ataturkut. Turqisht nuk merr vesh. Nuk e kupton përse i bërtasin policët. As në ëndërr nuk i pat shkuar ndër mend se në Turqinë tradicionale festja dhe çarçafi janë të ndaluara dhe shihen edhe më keq se në Jugosllavinë komuniste. Njëri nga policët ia tërheq me brutalitet çarçafin gruas së tij. Alomeroviç tenton ta mbrojë. Por në Turqi policia është njësoj si janë bakteret për organizatat ndërkombëtare: frikë dhe dridhma. Rebelimi i pakuptueshëm i cubit flokëverdhë me fes e tërbon fare policin. E rrëzon në tokë dhe fillon dhe e godet me shqelma sa e mbyt në gjak. Babai i doktor Jolçusë, i cili në Bijello Pole s'kishte dalë asnjëherë jashtë më larg se shtëpia e fundit e qytetit të tij, në Edrene nuk doli jashtë dyqanit të tij të argjendarisë deri në fund të jetës. Nuk mësoi asnjëherë asnjë fjalë turke. Edhe kështu nuk fliste shumë. Fjalët që thoshte shpesh ishin: “Botën e ka zaptuar shejtani.”.

Gjuha e parë që mësoi Hiqmeti ishte serbishtja dhe, me këtë gjuhë merrej vesh me prindërit, deri në vdekjen e tyre. Më erdhi mirë kur mora vesh se ishte me origjinë sllovene. Nuk ka lidhje me racat; problemi është tjetërkund. Dhe për atë nuk e kanë fajin turqit. Jemi vetë fajtorë. Njëherë e kam thënë se zaptuesit asnjëherë nuk largohen krejtësisht nga territori që kanë pushtuar. Ne, thjesht, nuk kemi lejuar që turqit të largohen. I kemi mbajtur në gjuhë. Në

libra. Në fotografitë artistike. Në histori. Kudo që ka qenë e mundur. Për ne, turqit janë ashtu si bakteret për OBSH-në: metodë frikësimi. Kur u larguan turqit, ne u bëmë turq.

Në fakt, në Qipro u binda se janë njerëz krejtësisht të ndershëm.

“Arritëm”, tha doktor Jolçu. Kishim zbritur poshtë në bodrumin e spitalit, me dyer të dala boje. “Dua t’ju paralajmëroj: pamja me të cilën do të ballafaqoheni nuk do të jetë aspak e këndshme.” Dhe nuk ishte. Pashë një djalë rreth dhjetë vjeç, lëkura e të cilit ishte mbuluar me njolla dhe krijonte përshtypjen e dizajnit të uniformës së kamuflazhit. Në shtratin pranë tij ishte shtrirë një djalë pak më i madh në moshë, dora e majtë e të cilit ishte ndarë në dy pjesë, sikur të ishin dy duar të veçanta. Pa dashur, preka me gisht lëkurën e djalit, për të parë a hiqej boja. Nuk hiqej. Në prekje, lëkura e tij ishte si lëkura e hardhucës. “Vitet e izolimit dhe të ndarjes së ishullit, - shpjegon dr. Jolçu, - kontribuuan për zhvillimin e mjekësisë me njohjen e sëmundjeve të panjohura deri tani. Nuk kalon vit që të mos dalë ndonjë sëmundje e re. Shumica janë vdekjeprurëse. Ç’është më e keqja nuk bëjmë dot asgjë.”

“Përse nuk i tregoni Van der Merit!”, gati sa nuk thirra unë. Doktor Jolçu mori frymë thellë dhe tha: “Histori e gjatë kjo.”. Pak më vonë, kur po pinim çaj në mensën e spitalit, dëgjova një pjesë të atij tregimi. Hiqmet Jolçu flet me një zë fare të ulët.

“Tashmë kam njëzet vjet që jetoj në Qipron e Veriut dhe kam një eksperiencë të madhe me organizatat

humanitare. Në fillim kisha besim tek ato. Por e kam humbur tash prej kohësh. Do të jem i hapur: ato organizata merren me gjithçka tjetër, përveç asaj që duhej të bënin. Mos e teproj: ka mes tyre dhe idealistë të cilët e marrin punën seriozisht, por ata janë të marginalizuar. Dhe si rregull, më të keqpagarit. Nga ana tjetër, ata janë një maskë e shkëlqyer për të korruptuarit, sepse hiperaktiviteti i tyre krijon përshtypjen se diçka po bëhet. Të marrim OBSH-në. Të dy e dimë se si funksionon, apo jo? Nga jashtë, pa asnjë të metë. Zakonisht delegacionet përbëhen nga persona nga të gjitha anët e botës. Janë përfshirë të gjitha racat. Të gjithë janë të sjellshëm. Por të shohim çfarë bëjnë: vizitojnë disa spitale; në pavijonet infektive dërgojnë sekretaret dhe përkthyesit me origjinë nga vendet e varfra. Kohën tjetër e kalojnë nëpër bare, pishina, apo me takime misterioze me njerëz që s'kanë lidhje me mjekësinë. Nuk kam prova, por mendoj se i rishesin ilaçet e destinuara për shëndetësinë e shteteve në të cilat veprojnë. Disa herë jam përpjekur të tërheq vëmendjen mbi sëmundjet e reja që janë shfaqur. Asnjëri nuk më ka dëgjuar! Jo se nuk kanë dashur të më dëgjojnë. Thjesht, s'më kanë dëgjuar. I kalonin fjalët e mia me një buzëqeshje pa të keq në fytyrë, ashtu si shenjtorët kalonin Detin e Vdekur duke ecur mbi ujë. Kështu qëndrojnë punët. Në këtë moment shkenca e mjekësisë ka arritur shkallën në të cilën për një kohë fare të shkurtër mund të çrrënjosë shumicën e sëmundjeve. Por kjo s'i shkon

ndër mend kurrkujt. Industria farmaceutike është një biznes tepër i madh.”

Javën tjetër, Vanja dhe unë jemi të ftuar për darkë në shtëpinë e Hiqmet Jolçusë, e cila ndodhet në pjesën turke të qendrës së Nikozisë, në Injon Meydan. Hiqmet Jolçusë nuk i pëlqejnë shoqëritë e mëdha. Përveç nesh, këtu është edhe Tansu Talati, mikesha e doktorit, profesoresha e gjuhës gjermane, e cila e adhuron Niçen. Ndryshe nga dr. Jolçu, Tansuja i përket rrethit të intelektualëve, që i kundërvihen bashkimit të ri të ishullit. “Kështu është më mirë për të dyja palët”, thotë ajo. Nuk është nacionaliste. Mendon se duhet të pastrohen fushat e minuara, të largohen telat me gjemba dhe të hapen kufijtë. Por nuk miraton rikrijimin e shtetit të përbashkët. “Përse?”, pyes. “Sepse ndihem turke vetëm në praninë e grekëve. Kur më rrethojnë anglezë, francezë, polakë, ndihem si Tansu. Por në praninë e grekëve gjithçka ndryshon. Kur i kam ata afër më mungon çarçafi, ndoshta nuk di fare sesi është ai: dëshiroj të mbyllem në ndonjë harem; më vjen të heq dorë nga e drejta e votimit; më vjen turp që kam mbaruar shkollën e lartë. Po, grekët kanë aftësinë të të bëjnë të ndihesh inferior. Ata na shikojnë si njerëz të dorës së dytë dhe kështu ka për të qenë përgjithmonë. Është e vërtetë se ne kemi ardhur në Qipro më vonë se ata. Por edhe ata janë të ardhur. Janë të ardhur të cilët pothuajse kanë zhdukur popullsinë autoktone.” S’po kuptoj asgjë. Asnjë nga historitë serioze të ishullit, që kam lexuar, nuk përmend ndonjë popullsi autoktone.

Nuk e përmend as propaganda turke, e cila nuk humb rastin për të hedhur baltë mbi grekët. Asnjë fjalë për atë dhe në arkivat pedante britanike të administratës koloniale. “Tansuja e ka fjalën për hurubët”, thotë Hiqmet Jolçuja! “Në rregull! - them unë. - Në qoftë se grekët kanë pasur arsye të fshehin ekzistencën e kësaj popullsie, përse nuk i përmendin anglezët?”

“Sepse edhe ata i kanë vrrarë! - thotë Tansuja. - Pastaj, - vazhdon ajo, - të shtunën mund t’ju shoqëroj deri në një nga tri fshatrat e mbetur në të cilat banojnë hurubët, për t’u bindur vetë.”

Edhe pse nuk më interesojnë fare hurubët, megjithëse përgjithësisht dyshoj se ekzistojnë, e pranoj ftesën me kënaqësi. Kjo do të thotë disa orë në shoqërinë e Tansu Talat, bukuria e së cilës shkëlqen plot klas në prapavijat e errëta të paragjykimeve të mia për turkeshat. Në shoqëritë e vogla ndryshimet e parëndësishme fshihen krejtësisht. Mendova se hurubët janë një komunitet i izoluar, një nga të shumtët në këtë ishull, ku ndryshimet e dialekteve janë aq të mëdha, sa njerëzit kuptohen me vështirësi nga një fshat në tjetrin. Do të shikoj se nuk është kështu. Por e shtuna është larg. Por edhe rruga për aty është e mbushur plot me ngjarje të shqetësuar. Kështu është në kohëra të turbullta: ose nuk ndodh asgjë, ose ndodhin gjëra të neveritshme. Por, prapëseprapë, në fillim premtimet gënjejnë për një fund të lumtur në mbarim. Të marrim Vanjën dhe Hiqmet Jolçunë. Rrinë bashkë të ulur në divan: s’ e kanë mendjen tek unë dhe

Tansu. E gjithë atmosfera më bën të mendoj se do të nisë një dashuri. Kjo më gëzon. Shikoj një shans për Vanjën. Është në një moshë për të kuptuar, se gjithçka për çfarë ka ëndërruar ndodh vetëm në telenovela. Dhe kjo pas shumë peripecish. Pas dhjetëra e dhjetëra episodesh të lodhshme. Po qe se do të martohet me doktorin melankolik, ka për të shpëtuar nga seria e pafundme e deziluzioneve, poshtërimeve; nga gjithë ato ikje pa shpresë tek alkooli dhe në fund, pas disa vitesh, nga vdekja e sigurt pas ndonjë sulmi terroristësh me bombë ndaj selisë së OKB-së në Bagdad. Vanja e ndien këtë instinktivisht. Ditët e ardhshme do të japë gjithçka nga vetja që ta ndalojë të rrjedhë fatin e keq. Tashmë nuk më viziton natën vonë në zyrë. Nuk pi. Kalon krejt kohën e lirë me Hiqmetin. Po i afrohet botës së bekuar të së përditshmes së qetë dhe fillon nga pak të humbasë interesin ndaj historive e tmerreve.

Të shtunën, Tansuja vjen të më marrë me xhip, para hotelit “Saray”. Nisemi për në Morfu, një qytet në veriperëndim të ishullit, të cilin banorët turq e quajnë Güzelyurt. Tansuja këmbëngul ta quajë edhe unë kështu. “Meqë ra fjala, ju jeni diplomuar për orientalistikë, jo helenistikë.” Morfu nuk është një rast i veçantë. Shumica e qyteteve në Qipro kanë nga dy emra. Disa edhe nga tre. Luka Famagusta (pas pushtimit ai është një qytet avetines) ka ndryshuar edhe gjininë, sepse për grekët ai është Amahostos. Për turqit është prapë i gjinisë femërore: Gazi Magusa. Pas gati një ore rrugëtim, Tansu ndalon

makinën. “Më tutje do të shkojmë më këmbë”, thotë ajo. Peizazhi rreth Morfit, i njohur për rritjen e mandarinave, mbulon gjelbërim të harlisur: pyje të dendura bambush, fier i lartë dhe bimë, për të cilat në gjuhët veriore nuk ekzistojnë emra.

Dalim në një fushë të hapur dhe Tansu më jep shenjë të ndaloj. “Arritëm, - thotë ajo. - Tani do të thërras myftarin. Duhet të tregohemi të kujdesshëm, sepse harubët janë shumë mosbesues. Dhe me të drejtë. Eksperienca e tyre me të huajt nuk është e mirë.” Pastaj mbledh duart në formë megafoni i afron te buzët dhe thërret: “Au, Yashar, ay!”. Pas pak dëgjohet një zë i çjerrë, që vjen nga shkurret: “Ay, Tansu! Hosh geldiniz!”¹. Nuk vonon dhe Jashari del më në fund nga pylli. Që në shikimin e parë e kuptoj pse anglezët i kanë vrarë hurubët. Jashari është me një shtat rreth tetëdhjetë centimetra: ka veshur një palë rroba banje me ngjyra, i armatosur me një shtizë të gjatë. Lëkurën e ka të zezë, të errët. Flokët si të hienës, një përzierje e padepërtueshme tufash të kuqërremta, të zeza dhe të thinjura. Fytyra, në të cilën mezi shihet një hundë e shtypur, është plot rrudha të thella. Dhe për çudinë time më të madhe, e zbukuruar me mustaqe të trasha niçeane. Ky përshkrim vlen dhe për hurubët e tjerë. I ngjajnë njëri-tjetrit si veza vezës dhe që të gjithë me mustaqe, krejt kopje e mustaqeve të Niçes. U binda për këtë kur hymë në fshat: rreth pesëdhjetë

¹ Mirëserdhët! (turqisht)

shtëpi prej kallamash dhe balte të vendosura në formë rrrathësh koncentrikë rreth shtëpisë së Jasharit që ndodhet në qendër. Pozicioni i shtëpive ka të bëjë me pozitën e zotit të saj në shoqëri dhe lidhet ngushtë me shpërndarjen e ushqimit dhe të drejtat e përgjithshme. Në kthim Tansuja më shpjegon se në rrethin e parë vendosin rojat e zjarrit: detyra e tyre e vetme është ta mbajnë zjarrin ndezur para kasolles së myftarit. Në rrethin e dytë, duke pasur parasysh punën komplekse që bëjnë, janë kasollet e druvarëve, një rang shumë i vlerësuar të hurubët. Është e vërtetë që druri ka rëndësi të veçantë për zjarrin e fisit: nëpërmjet rrymës së nxehtë ai largon insektet dhe gjarpërinjtë, por njëkohësisht shmanget tymi i cili mund të tërheqë vizitorë të padëshiruar. Ka dhe të tillë. Kureshtja, është për të ardhur keq, shpeshherë sjell fatkeqësi. Për këtë dëshmojnë trupat e tharë dhe të mbushur me kashtë të tre turistëve suedezë, që ndodhen në një kasolle të mbuluar me kallama, si në njëfarë muzeu primitiv, që të tre me aparatet fotografike rreth qafës, të vendosur pranë mumieve të vjetra të disa ushtarëve britanikë, vvarë nga hurubët gjatë luftës antikolonialiste.

Në rrethin e tretë koncentrik ndodhen shtëpitë e gjuetarëve të minjve që janë njëkohësisht dhe kuzhinierët e fshatit. Përveç minjve, gjuetarët mbledhin edhe breshka. Me këtë rreth mbaron kasta e të privilegjuarve, e atyre që hanë mish. Katër unazat e tjera ushqehen me rrënjë dhe fruta të egra. Por gjithçka që mbledhin janë të detyruar t'ia dorëzojnë